



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr. 2958 Prot

Maliq më, 27.05.2022

**NJOFTIM SHPALLJE FITUESI**

**“Mbi zhvillimin e ankandit për dhënien me qira të tokës së pandarë bujqësore Nr. 87/16, ZK 3010, fshati Podgorie, e llojit “arë” me sipërfaqe 430 642 m<sup>2</sup>, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq”**

Në mbështetje të nenit 9, pika 1.2, gërma a, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 8312 datë 26.03.1998 “Për Tokat Bujqësore të Pandara”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.364, datë 01.04.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Vreshtas të Qarkut të Korçës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 21.08.1998 “Për Tokat Bujqësore të Pandara”, Udhëzimit Nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, Kreu II pika 11, si dhe Vendimit Nr.2, datë 26.05.2022 të Komisionit të Qiradhënies së Tokës Bujqësore të Pandarë (KQTBP) pranë Bashkisë Maliq “Për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandarë, nr.87/16, zk 3010, Fshati Podgorie, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq”, Bashkia Maliq njofton se,

1. Me Vendimin Nr.2, datë 26.05.2022 të Komisionit të Qiradhënies së Tokës Bujqësore të Pandarë (KQTBP) pranë Bashkisë Maliq, fituesi i ankandit për marrjen me qira të tokës bujqësore të pandarë me Numër Pasurie 87/16, Zonë Kadastrale 3010, Sipërfaqe 430 642 m<sup>2</sup>, Fshati Podgorie, Njësia Administrative Vreshtas, është shpallur subjekti “Bashkimi i Përkohshëm” i Shoqërisë “FAVINA” Shpk dhe Fermerit Adnan Mara.
2. Mbas mbarimit të afatit të njoftimit me subjektin fitues do të lidhet Kontrata Tip e përcaktuar sipas Urdhërit Nr.13, datë 15.01.2013, të Ministrit të Bujqësisë.
3. Ky njoftim publikohet në ambjentet e Bashkisë Maliq, Njesisë Administrative Vreshtas dhe në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Maliq.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Gëzim TOPÇIU**



Nr. 68 Prot

Adresa: Bulevardi “Rinia”, Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026

www.bashkiamaliq.gov.al